Nr. 3886/1
Data: 21.06.2023

REPUBLIKA E SHQIPERISË
**PREFEKTI QARKU FIER**
**SEKTORI JURIDIK**

Nr. 645/1 Prot.　　　　　　　　　　　　　　Fier, më 20.06.2023

Lënda: Kthim përgjigje për vendimet e mbledhjes së parë të Këshillit Bashkiak Roskovec Nr. 54 dhe Nr. 57 datë 14.06.2023.

**BASHKISË ROSKOVEC**

**KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC**

**Roskovec**

Në përgjigje të shkresës Tuaj me Nr. 3886 Regj. datë 14.06.2023, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 645 prot. datë 19.06.2023 me anë të së cilës na keni dërguar vendimet e mbledhjes së parë të këshillit bashkiak Roskovec Nr. 54 datë 14.06.2023 "*Mbi miratimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit të Bashkisë Roskovec*" dhe Nr. 57 datë 14.06.2023 "*Mbi zgjedhjen e përfaqësuesve të këshillit të bashkisë Roskovec, në Këshillin e Qarkut Fier*" datë shoqëruar nga:

- Procesverbal i komisionit të mandateve për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit të Bashkisë datë 14.06.2023;
- Lista emërore e anëtarëve të këshillit të Bashkisë Roskovec, zgjedhur më 14.05.2023 të mandatuar në mbledhjen e konstituimit të datës 14.06.2023;
- Vendimi i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve për "*Shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për këshillin e Bashkisë Roskovec, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023*" Nr. 583 datë 24.05.2023;
- Procesverbali i komisionit të votimit për votimin për përfaqësuesit në Këshillin e Qarkut Fier datë 14.06.2023;
- Formula e Betimit e Kryetarit të Bashkisë Roskovec Znj. Majlinda Bufi Nr. 3881 Prot. datë 14.06.2023;
- Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Roskovec Nr. 62-2023-2191 (4) datë 05.06.2023, "*Mbi vërtetimin e mandatit të Kryetarit të Bashkisë*";
- Procesverbali i mbledhjes datë 14.06.2023 i protokolluar në librin e procesverbaleve Nr. 112 Prot. datë 10.01.2023;

Ju bëjmë me dije se,
Prefekti i Qarkut Fier, në përmbushje të detyrave që i ngarkon Ligji Nr. 107/2016 "*Për Prefektin e Qarkut*", neni 8 shkronja "j"; Ligji Nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" (i ndryshuar) nenet 46 dhe 73, i'u ka dërguar në muajin janar 2023 shkresën me Nr. 115 Prot. Datë 30.01.2023 "*Për përcaktimin e numrit të anëtarëve të këshillave bashkiak dhe anëtareve të Këshillit të Qarkut në Qarkun Fier*". Me anë të saj ka përcaktuar se numri i anëtarëve të Këshillit Bashkiak Roskovec është 21 anëtarë dhe numri i përfaqësuesve të këshillit të bashkisë Roskovec në Këshillin e Qarkut Fier është 4 anëtarë (3 anëtarë+kryetari i bashkisë).

Për sa më sipër, vendimi Nr. 54 datë 14.06.2023 "*Mbi miratimin e Mandateve të anëtarëve të Këshillit të Bashkisë Roskovec*" i dërguar nga ana juaj është në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" (i ndryshuar) neni 7 pikat 1, 2, 4; neni 8 pika 2 neni 46 pika 2; neni 48; Vendimit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve Nr. 583 datë 24.05.2023 " *Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për këshillin e Bashkisë Roskovec, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023*" dhe në përputhje me përcaktimet e dërguara nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën me Nr. 115 Prot. datë 30.01.2023.

Gjithashtu edhe vendimi Nr. 57 datë 14.06.2023 "*Mbi zgjedhjen e përfaqësuesve të këshillit të bashkisë Roskovec, në Këshillin e Qarkut Fier*" i dërguar nga ana juaj është në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" (i ndryshuar) neni 7 pika 5; neni 8 pika 2; neni 48 pika 6 shkronja "d"; neni 73 pikat 2, 3 dhe 4 si dhe në përputhje me përcaktimet e dërguara nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën me Nr. 115 Prot. datë 30.01.2023.

**Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,**

**PREFEKTI**

**Lefter Shehaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI QARKUT FIER -

**R E P U B L I K A   E   SH Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA ROSKOVEC**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.3882 Prot. Roskovec,më 14 . 06 2023

# VENDIM

**NR 54 .DATË 14 . 06 .2023**

***"MBI MIRATIMIN E MANDATEVE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC"***

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* neni 48 pika 6,gërma b dhe c,pika 7, neni 50 pika 1; mbështetur në procesverbalin e Komisionit të Vërtetimit të Mandateve,në mbledhjen e konstituimit,Këshilli i Bashkisë,

**<u>VENDOSI :</u>**

1- Miratimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit të Bashkisë Roskovec sipas listës bashkëngjitur.
2- Ngarkohet Sekretaria e Këshillit Bashkiak me zbatimin e këtij vendimi.
3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**

**Afrim Plaka**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ROSKOVEC -

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA ROSKOVEC**
**KËSHILLI**

PROCESVERBAL I KOMISIONIT TË MANDATEVE PËR VERIFIKIMIN E MANDATEVE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË

I mbajtur sot më datë 14 / 06 /2023, në mbledhjen e parë të komisionit të mandateve për verifikimin e mandateve për anëtar të këshillit bashkiak.

Komisioni i mandateve i përbërë nga zotërinjtë:
z. Ermira Buzi,
z. Antuena Pelo,
z. Habibe Hejdini,

Në mbledhjen e tij të parë vendosi të zgjedhë:
z. Ermira Buzi, kryetar i komisionit të mandateve
z. Antuena Pelo, zëvendëskryetar i komisionit të mandateve
z. Habibe Hejdini, sekretar i komisionit të mandateve

Pasi verifikoi dokumentacionin paraqitur për vërtetimin e mandateve për anëtarë të këshillit të Bashkisë Roskovec konstatoi se:
Marrin pjesë në mbledhje 19 anëtarë.
Nuk marrin pjesë në mbledhje 2 anëtarë.
Vërtetohet vlefshmëria e mandateve 19 anëtarë.
Nuk vërtetohen mandatet për 2 anëtarë:
Për arsye shëm defesorp
.

Vërtetohen mandatet emër për emër sipas listës bashkëngjitur. Mbas votimit këshilli i Bashkisë Roskovec quhet i konstituar pasi marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të mandatuar.

KOMISIONI I MANDATEVE

| Zv.kryetar | Kryetar | Sekretar |
|---|---|---|
| Antuena Pelo | Ermira Buzi | Habibe Hejdini |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ROSKOVEC**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Lista emërore e anëtarëve të Këshillit të Bashkisë Roskovec,zgjedhur më 14.05.2023 ,të mandatuar në mbledhjen e konstituimit të datës 14.06.2023

| Nr. | Emër Atësia Mbiemër | Subjekti Politik | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1. | AFRIM IDAJET PLAKA | PARTIA SOCIALISTE | |
| 2. | ESMERALDA TRIFON MUSKO | PARTIA SOCIALISTE | |
| 3. | RRAPI NAMIK HAZIZI | PARTIA SOCIALISTE | |
| 4. | FLORIANA OSMËN HOXHA | PARTIA SOCIALISTE | |
| 5. | LEKSI LONI GOGA | PARTIA SOCIALISTE | |
| 6. | ERMIRA PETREF BUZI | PARTIA SOCIALISTE | |
| 7. | ZHAKU SHKELQIM METUSHI | PARTIA SOCIALISTE | |
| 8. | ELIZABETA XHAFERR KAÇELI | PARTIA SOCIALISTE | |
| 9. | NAZMI DYRMISH ZEKA | PARTIA SOCIALISTE | |
| 10. | HABIBE NAMIK HAJDINI | PARTIA SOCIALISTE | |
| 11. | ELMAS HASAN ÇEPELE | PARTIA SOCIALISTE | mungon |
| 12. | ELISABETA MEDI TOSKA | PARTIA SOCIALISTE | |
| 13. | EMELS BEKTASH XHAXHAJ | BASHKË FITOJMË | |
| 14. | DHURATA MALIQ MALKA | BASHKË FITOJMË | |
| 15. | JORGO FERIDUN BEGAJ | BASHKË FITOJMË | |
| 16. | PEGIOLA PËLLUMB TORO | BASHKË FITOJMË | mungon |
| 17. | AMARILDO ZANI HOXHA | BASHKË FITOJMË | |
| 18. | VIOLA ARJAN ÇEPELE | BASHKË FITOJME | |
| 19. | ANTUENO LUAN PELO | BASHKË FITOJMË | |
| 20. | SARA NUSRET BIBO | PARTIA DREJTËSI,INTEGRIM DHE UNITET | |
| 21. | FREDI BAKI FELEQI | PARTIA BALLI KOMBËTAR | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.3883 Prot. Roskovec,më 14 , 06 2023

**VENDIM**

**NR 55 .DATË 14 . 06 .2023**

***"MBI ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC"***

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*neni 48 pika 2 dhe pika 6,gërma ç,neni 54 gërma b dhe neni 56 pika 1,Këshilli i Bashkisë Roskovec,në mbledhjen e tij të konstituimit,

**VENDOSI :**

1- Z. **Afrim Idajet Plaka** zgjidhet Kryetar i Këshillit të Bashkisë Roskovec.
2- Ngarkohet Sekretaria e Këshillit Bashkiak me zbatimin e këtij vendimi.
3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Afrim Plaka**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ROSKOVEC

**R E P U B L I K A E SH Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA ROSKOVEC**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.3884 Prot. Roskovec,më 14 . 06 2023

**VENDIM**

**NR 56 .DATË 14 . 06 .2023**

***"MBI ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC"***

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* neni 48 pika 2 dhe pika 6,gërma ç,neni 54 gërma b dhe neni 56 pika 1,Këshilli i Bashkisë Roskovec,në mbledhjen e tij të konstituimit,

**VENDOSI :**

1- **Znj.Ermira Petref Buzi** dhe **Znj.Sara Nusret Bibo** zgjidhen Zëvendëskryetar të Këshillit të Bashkisë Roskovec.
2- Ngarkohet Sekretaria e Këshillit Bashkiak me zbatimin e këtij vendimi.
3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**

**Afrim Plaka**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ROSKOVEC

**R E P U B L I K A  E  SH Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA ROSKOVEC**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3885 Prot. Roskovec,më 14 . 06 2023

**VENDIM**

**NR 57 .DATË 14 . 06 .2023**

***"MBI ZGJEDHJEN E PËRFAQËSUESVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC NË KËSHILLIN E QARKUT FIER"***

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* neni 48 pika 2 dhe pika 6,gërma d,neni 54 gërma i, si dhe në zbatim të shkresës së Prefektit të Qarkut Fier Nr.115 Prot. datë 30.01.2023,Këshilli i Bashkisë Roskovec,në mbledhjen e tij të konstituimit,

**<u>VENDOSI :</u>**

1- Zgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit të Bashkisë Roskovec në Këshillin e Qarkut Fier si më poshtë :

1. **Z. Leksi Loni Goga**
2. **Znj. Esmeralda Trifon Musko**
3. **Z. Rrapi Namik Hazizi**

2- Ngarkohet Sekretaria e Këshillit Bashkiak me zbatimin e këtij vendimi.

3-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**

**Afrim Plaka**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ROSKOVEC -